



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

## RAPORTI I AUDITIMIT

PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR QËLLIME TË VEÇANTA PËR  
PROJEKTIN

“ KONKURRUESHMËRIA DHE GATISHMËRIA PËR EKSPORT ”  
PËR PERIUDHËN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

***Auditim në bazë të marrëveshjes për projektin e financuar nga mjetet e ndara prej Bankës Botërore***

Prishtinë, Korrik 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të *Projektit "Konkurrueshmëria dhe Gatishmëria për Eksport"* në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Vlora Spanca , e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Jetmira Isufi (*udhëheqëse e ekipit*) si dhe Jehona Krasniqi (*anëtare ekipi*), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Mujë Gashi.

## TABELA E PËRMBAJTJES


Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	5
2 Pasqyrat financiare vjetore për qëllime të veçanta dhe opinionimi i auditimit .....	6
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	8
Shtojca II: Letër konfirmimi.....	11
Shtojca III: Pasqyrat Financiare Vjetore për Qëllime të Veçanta të projektit për vitin 2018 .....	12

# Përmbledhje e përgjithshme

## Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore për Qëllime të Veçanta për Projektin “ **Konkurrueshmëria dhe Gatishmëria për Eksport** ” për vitin e përfunduar më 31.12.2018, i cili përfshinë Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me raportin financiar.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe nga Njësia Koordinuese e Projektit.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm

### Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare për Qëllime të Veçanta *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

#### **Theksimi i çështjes**

Ne tërheqim vëmendjen tuaj, për faktin që Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me kornizën për qëllime të veçanta dhe për pasojë pasqyrat financiare nuk mund të përdoren për një qëllim tjetër.

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

## Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e raportit financiar dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare për qëllime të veçanta japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të gjitha fondet e jashtme janë përdorur në përputhje me kushtet e marrëveshjeve përkatëse të financimit;
- Nëse të dhënat, sistemet dhe transaksionet financiare janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në zbatim për fondet e ndara nga Banka Botërore-IDA;
- Nëse pasqyrat financiare janë në pajtim me kërkesat e marrëveshjes së veçantë ndërmjet Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Bankës Botërore;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Metodologjia e auditimit është fokusuar në ekzaminimin e të dhënave dhe transaksioneve financiare, përfshirë dokumentacionin mbështetës. Ne kemi përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar. Në raport do të vendosen gjetjet që janë pjesë e opinionit për pasqyra financiare. Ndërsa gjetjet që kanë të bëjnë me aspektin e menaxhimit financiar, funksionimin e kontrollit të brendshëm dhe çështjet e pajtueshmërisë do të paraqiten në Letër Menaxhment.

## 2 Pasqyrat financiare vjetore për qëllime të veçanta dhe opinionin e auditimit

### Hyrje

Auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për qëllime të veçanta merr parasysh pajtueshmërinë me kërkesat për raportim konform marrëveshjes si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në pasqyra financiare.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinionin e pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar pasqyrat financiare për qëllime të veçanta të projektit " Konkurrueshmëria dhe Gatishmëria për Eksport " i cili është financuar nga Banka Botërore-IDA, për vitin e përfunduar më 31.12.2018, i cili përfshinë një përmbledhje të burimit të fondeve dhe shpenzimeve të realizuara, pasqyrën e aplikimeve për tërheqjen e fondeve, dhe shpalosjet.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare për qëllime të veçanta në lidhje me projektin "Konkurrueshmëria dhe Gatishmëria për Eksport" për vitin e përfunduar më 31.12.2018, paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat për raportim në marrëveshjen në mes të palëve, duke respektuar parimet e kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

#### Baza për opinionin

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

#### Theksim i çështjes – Baza për kontabilitet

Ne tërheqim vëmendjen tuaj, për faktin që Pasqyrat Financiare për qëllime të veçanta janë përgatitur në përputhje me kornizën për qëllime të veçanta dhe për pasojë pasqyrat financiare nuk mund të përdoren për një qëllim tjetër. Këto pasqyra janë përgatitur që t'i ndihmojnë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për të plotësuar kërkesat e përcaktuara nga Banka Botërore. Si rezultat i kësaj këto pasqyra financiare mund të mos jenë të përshtatshme për ndonjë qëllim tjetër.

Opinionin e jonë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

## **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje**

Menaxhmenti i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është përgjegjës për përgatitjen e drejtë dhe të vërtetë të pasqyrave financiare për qëllime të veçanta, konform marrëveshjes së nënshkruar në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, këto informata përbëhen nga Pasqyra e Fondeve dhe Përdorimi i tyre si dhe nga Pasqyra e tërheqjes së Fondeve dhe shpalosjet.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për pasqyrat financiare për qëllime të veçanta në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtij raporti financiar.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në pasqyrat financiare për qëllime të veçanta. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në raportin financiar, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare për qëllime të veçanta nga Ministria, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të raportit financiar.

# Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

## Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

## Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

## Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të



përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm.

Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry*  
*Kabineti i Ministrat - Kabinet Ministra - Cabinet of the Minister*

Prishtinë, 27.06.2019

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e Auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:


- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare për qëllime të veçanta për projektin e financuar nga Banka Botërore "Konkurrueshmëria dhe Gatishmëria për Eksport", për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018.
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Endrit SHALA

Ministër



## Shtojca III: Pasqyrat Financiare Vjetore për Qëllime të Veçanta të projektit për vitin 2018



**Competitiveness and Export Readiness**

**Project**

(IDA Credit number 6035 - XK)

( P152881)

**Financial Statements**

for the year ended December 31, 2018

**Content**

<b>Financial Statements of the project</b>	<b>Page</b>
• Statement of Sources and Uses of Funds for the year ended 31 December 2018	1
• Statement of expenditures for the year ended 31 December 2018	2-3
• Notes to the Financial Statements as at 31 December 2018	4-12
<i>Supplementary schedule to the Financial Statements:</i>	
• Accumulated statement of expenditures for the period from 18 May 2018 (inception date) up to 31 December 2018	i - ii

## Competitiveness and Export Readiness Project

(IDA Credit No. 6035 - XK)

## Statement of Sources and Uses of Funds

for the year ended December 31, 2018

(in EUR unless otherwise stated)

	Notes	Year ended on December 31, 2018	Year ended on December 31, 2017	From May 18, 2018 (Inception date) to December 31, 2018
<b>Sources of Funds:</b>				
IDA Credit No. 6035 - XK funding	4	0.00	0.00	0.00
Temporary advances by Government of Kosovo	5	(41,526.97)	0.00	(41,526.97)
<b>Total Sources of Funds</b>		<b>(41,526.97)</b>	<b>0.00</b>	<b>(41,526.97)</b>
<b>Uses of Funds:</b>				
Grants	6	0.00	0.00	0.00
Goods	7	(4,293.00)	0.00	(4,293.00)
Non Consulting Services		-	-	0.00
Consulting services	8	(27,588.45)	0.00	(27,588.45)
Training and workshop	9	(1,324.24)	0.00	(1,324.24)
Incremental operating costs	10	(8,321.28)	0.00	(8,321.28)
<b>Total Uses of Funds</b>		<b>(41,526.97)</b>	<b>(0.00)</b>	<b>(41,526.97)</b>

The Statement of Sources and Uses of Funds is to be read in conjunction with the notes set out on pages 4 to 13 and forming an integral part of the financial statements.

The financial statements of the Competitiveness and Export Readiness Project (IDA Credit No.6035) were authorised for issue by the management of the Project under Ministry of Trade and Industry on May 2019 and signed on its behalf by:

  
12.06.2019  
Gazmend MEJZINI  
Project Coordinator

  
12.06.2019  
Adile OSMANI  
Financial Management Officer

**Competitiveness and Export Readiness Project**  
**(IDA Credit number 6035 - XK)**

**Notes to the financial statements**  
for the year ended 31 December 2018  
*(in EUR unless otherwise stated)*

---

**1. General**

The Financing Agreement for the **Competitiveness and Export Readiness Project (CERP)** (IDA Credit number 6035 - XK)- (the "Project"), was signed between the International Development Association ("Association") and the Republic of Kosovo or the "Recipient" on 02 August, 2017 and be effective on date May 18, 2018

At the commencement of the Project, the Government of Kosovo (the "Recipient") established a Project Implementation Unit ("PIU") within Ministry of Trade and Industry to implement, monitor, control and completes the operation of the Project.

At 31 December 2018, the Project had 5 employees

The Association agrees to extend to the Recipient, on the terms and conditions set forth or referred this Agreement, a Credit in the amount of fourteen million three hundred thousand Euros (EUR 14,300.000) (variously, "Credit" and "Financing") to assist in financing the project described in Schedule 1 to this Agreement ("Project").

**Project Description**

The objective of the Project is to assist the Recipient in supporting product certification for export markets, strengthening the capacity of export-oriented firms and reducing the cost of business inspections.

**The Project consists of the following parts:**

**Part I. Enhancing Business Environment and Export Readiness**

*A. Supporting international recognition of National Quality Infrastructure ("NQI")*

Provision of goods and technical assistance to improve, and obtain international recognition of, the Recipient's NQI, by specifically:

- (i) supporting the Kosovo Metrology Agency ("KMA") to upgrade selected metrology laboratories, train its staff to use the newly procured equipment, and build its staffs capacity to improve traceability and inter-laboratory comparisons;
- (ii) supporting the Kosovo Accreditation Directorate ("KAD") and Kosovo Standardization Agency to enhance their information technology systems with respect to data interoperability and exchange, and to facilitate their access to information on standards and test results, and, specifically for KAD, to accredit laboratories in line with international best practice; and
- (iii) supporting the establishment of an NQI Committee ("NQIC") with private sector participation, and improving public awareness of international standards and harmonization requirements.

*B. Supporting Small and Medium Enterprises ("SMEs ") to improve export readiness*

- (i) Establishment and administration of a Matching Grant program; and



*Competitiveness and Export Readiness Project*

(IDA Credit No. 6035 - XK)

**Notes to the financial statements**

for the year ended 31 December 2018

(in EUR, unless otherwise stated)

---

- (i) Provision of Matching Grants to provide technical assistance to Selected SMEs with export potential to carry out Matching Grant Subprojects that (a) implement international standards and receive certifications required for export markets, and (b) gain access to business development services.

*C. Reforming business inspections system*

Reforming the Recipient's business inspections system by reducing the administrative burden to businesses and improving the efficiency and effectiveness of inspection services, through the provision of:

- (i) an electronic inspector data management system;
- (ii) a business inspection interoperability data exchange system;
- (iii) equipment for inspectors to conduct field analyses, sampling and evidence gathering; and
- (iv) support for institutional set-up and capacity building for inspectors.

**Part 2. Project Implementation and Coordination Support**

Provision of goods, services, Training and Operating Costs in support of Project implementation and coordination, including the provision of equipment and of technical assistance in Project management, coordination, and fiduciary and monitoring and evaluation functions.

The closing date is: October 30, 2022

*Competitiveness and Export Readiness Project*

(IDA Credit No. 6035 - XK)

**Notes to the financial statements**  
for the year ended 31 December 2018  
(in EUR, unless otherwise stated)

**IDA Credit No. 6035 – XK**

The following table specifies the categories of Eligible Expenditures that may be financed out of the proceeds of the Financing ("Category"), the allocations of the amounts of the Financing to each Category, and the percentage of expenditures to be financed for Eligible Expenditures in each Category:

Category	Amount of the Credit allocated (expressed in EUR)	Percentage of expenditures to be financed
1) Goods, non-consulting services, consultants services for the project except for Part I.B(ii)	12,000,000	100%
2) Part I.B(ii) of the Project	2,300,000	100%
<b>Total</b>	<b>14,300,000</b>	

**IDA Credit 6035-XK (continued)**

The Government of Kosovo will repay the principal amount of the Credit in semi-annual instalments payable as of describe in following:

Date Payment Due	Principal Amount of the Credit repayable (expressed as a percentage)*
On each April 15, and October 15: commencing on October 15, 2022 to and including April 15, 2032	1.65 %
and commencing on October 15, 2032 to and including April 15, 2042	3.35 %

\* The percentages represent the percentage of the principal amount of the Credit to be repaid, except as the Association may otherwise specify pursuant to Section 3.03(b) of the General Conditions.

The payment currency is Euro

The Closing date of the project is October 30, 2022

**Competitiveness and Export Readiness Project**  
**(IDA Credit number 6035 - XK)**

Notes to the financial statements  
for the year ended 31 December 2018  
(in EUR unless otherwise stated)

**2. Basis of preparation**

The special purpose financial statements of the project for the year ended December 31, 2018 have been prepared for the purpose of complying with the provisions of the Project's objectives, the World Bank guidelines and terms and conditions of the IDA Credit no. 6035 - XK.

The special purpose financial statements comprise the Statement of Sources (Cash Receipts) and Uses (Payments); the Statement of Expenditure used as the basis for the submission of withdrawal applications for the year ended December 31, 2018 and a summary of significant accounting policies and other explanatory notes.

The Cumulative Statements of Expenditures used as the basis for the submission of withdrawal applications for the period from inception on May 18, 2018 till December 31, 2018 are presented as supplementary schedules. Cumulative information on receipts and disbursements from the Project's inception date till December 31, 2018 is presented in the Statement of Sources and Uses of Funds for information purposes only.

The special purpose financial statements have been prepared in accordance with cash basis IPSAS - Financial Reporting under the Cash Basis of Accounting, which differs from Kosovo and International Financial Reporting Standards. On this basis, income is recognised when received rather than when earned and expenses are recognised when paid rather than when incurred. Accordingly, direct and indirect payments of the Project's expenses, which are made from the proceeds of the Grants & Credit, are recognised as sources and uses of funds at the time the payment is made.

The special purpose financial statements are presented in Euros ("EUR"), unless otherwise stated.

**3. Summary of significant accounting policies**

A summary of significant accounting policies underlying the preparation of the Project's financial statements is presented below.

**3.1 Foreign currency transactions**

The project accounts are maintained in Euros ("EUR") the legal currency of Kosovo. The Project deals predominantly in EUR, while the foreign currencies the Project deals with are predominantly in Special Drawing Rights ("SDR") and United State Dollars ("USD")

Initial grant amount are maintained at the historical exchange rates. The project translates the undrawn grant balance at the rates in effect on the year end. The exchange rates in effect as at April 1, 2017 were as follows:

Currency	2017	2016
USD/ XDR	0.71	0.72
XDR /USD	1.40	1.39
EUR /XDR	0.80	0.79
XDR /EUR	1.23	1.25
EUR/ USD	1.06	1.07

*Competitiveness and Export Readiness Project*

(IDA Credit No. 6035 - XK)

**Notes to the financial statements**

for the year ended 31 December 2018

*(in EUR, unless otherwise stated)***3.2 Recognition of income and expenses**

Income is recognised when received rather than when earned, and expenses are recognised when paid rather than when incurred.

**3.3 Taxation**

The Project is not exempt from Value Added Tax (VAT) and Custom Duties for the credits part. The local employees of the project are liable for personal income tax and social security contributions.

**4. IDA Credit No. 6035 - XK funding**

IDA Credit funding is composed as follows:

Funding	Year ended December 31, 2018	Year ended December 31, 2017
Reimbursements	0.00	0.00
<b>Total</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>

*As at 31 December 2018, we did not have any reimbursement from the Credit*

**5. Temporary advances received by government of Kosovo**

The temporary advances received by Government of Kosovo are composed as follows:

Funding	Year ended December 31, 2018	Year ended December 31, 2017
IDA Credit 6035-XK temporary advances received by GoK	(41,526.97)	0.00
<b>Total</b>	<b>(41,526.97)</b>	<b>0.00</b>

**6. Goods**

Expenditures for goods are detailed as follows:

Item	Year ended December 31, 2018	Year ended December 31, 2017
IT Equipment for PIU Staff	4,293.00	0.00
<b>Total</b>	<b>4,293.00</b>	<b>0.00</b>

*Competitiveness and Export Readiness Project*

(IDA Credit No. 6035 - XK)

**Notes to the financial statements**  
for the year ended 31 December 2018  
(in EUR, unless otherwise stated)

**7. Consultant services**

Consultant services are detailed as following:

Item	Year ended 31-Dec-18	Year ended 31-Dec-17
<b>Staff Salaries</b>	<b>27,588.45</b>	-
Gazmend Mejzini Net Salaries for Jun- Dec'18	8,491.65	-
Aferdita Selmani Net Salaries for May-Dec'18	8,214.60	-
Adile Osmani Salaries Net for July-Dec'18	5,211.90	-
Valmire Morina Salaries Net for Nov-Dec'18	939.80	-
Mimoza Ramadani Salaries Net for Nov-Dec'18	810.60	-
Taxes for staff salaries from May-Nov'18	1,684.90	-
Pension Contribution from Employee 5% for staff salaries from May Nov'18	1,117.50	-
Pension Contribution from Employer 5% for staff salaries from May- Nov'18	1,117.50	-
<b>Total</b>	<b>27,588.45</b>	-

\*Liabilities from 2018 that were paid on 2019:

- closing advances for official travel - Study Tour in Turkey in amount of 6,357.75 Euro for PIU and MTI staff
- closing Petty Cash for office expenses made during the year 2018 in amount 1,119.18 Euro
- payment for Taxes for Kosovo Administration for PIU staff salaries for December'18 in amount of 353.55 Euro
- Pension Contribution from Employer 5% for staff salaries for Dec'18 in amount of 244.50
- Pension Contribution from Employer 5% for staff salaries for Dec'18 in amount of 244.50

In total : **8,319.48 Euro**

**8. Training**

Expenditures for training are detailed as follows:

Item	Year ended December 31, 2018	Year ended December 31, 2017
PIU and MTI staff participation on Study Tour in Turkey	1,324.24	-
<b>Total</b>	<b>1,324.24</b>	<b>0.00</b>

*Competitiveness and Export Readiness Project*  
(IDA Credit No. 6035 - XK)

**Notes to the financial statements**  
for the year ended 31 December 2018  
(in EUR, unless otherwise stated)

**9. Incremental operating costs**

Expenditures for Incremental operating costs are detailed as follows

Item	Year ended December 31, 2018	Year ended December 31, 2017
Cost for Translation services	351.46	
Cost for advertisements	240.00	
Telecommunication costs	1,820.00	
Office Supplies -IT Equipment	1,590.00	
Office supply	3,994.82	
Costs for Internet services	108.00	
Cost for official lunch	217.00	
<b>Total</b>	<b>8,321.28</b>	

## Competitiveness and Export Readiness Project

(IDA Credit No. 6035 - XK)

Notes to the financial statements  
for the year ended 31 December 2018  
(in EUR, unless otherwise stated)

**10. Expenditures by project part**

The expenditures by Project Parts are as follows:

Parts	Grants	Goods	Consult. Services	Training	Non Consulting	IOC	Total 31 December 2018
Part A							9,045.64
Part B							
<b>Total</b>	-	4,293.00	27,588.45	1,324.24	-	8,321.28	41,526.97

**Competitiveness and Export Readiness Project**

(IDA Credit number 6035 - XK)

( P152881)

**Statement of cumulative expenditures withdrawal schedule**

For the period from 18 May 2018 (inception date) to ended 31 December 2018

(Supplementary schedule to the Annual Financial Statements)

A.O



*Competitiveness and Export Readiness Project*

(IDA Credit No. 6035 - XK)


**Statement of cumulative expenditures withdrawal schedule**

For the period from 18 May 2018 (inception date) to ended 31 December 2018  
*(in EUR, unless otherwise stated)*

**IDA credit No. 6035-XK**

Withdrawal application	Type of application	Appl. Pym. Amt	Disbursed	Civil works	Goods	Training	Consultant services	Technical services	Incremental Costs	SOE	Deducted	Date received	Value date
CERP01	Reimbursement	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

**Total reimbursement** - - - - -

  
 Gazmend MEZINI  
 Project Coordinator

  
 Adile-OSMANI  
 Financial Management Officer